KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com

KOLEGJI DARDANIA - DARDANIA COLLEGE
Prishtinë - Pristina
04 Nr. 582/031 DI 21.09.2021

Në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit "Dardania", Prishtinë, Këshilli drejtues i Kolegjit, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.09.2021 miratoi

KODIN ETIK TË KOLEGJIT "DARDANIA"

Kodi Etik përcakton standarde themelore të sjelljes etike për tërë komunitetin e Kolegjit Dardania: për stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ, për marrëdhënie të mira ndërpersonale për të gjithë komunitetin.

Kodi Etik synon të ndërtojë të mbajë standarde të larta etike në mesin e anëtarëve të komunitetit të Kolegjit, të përforcojë besnikërinë, të sigurojë transparencë dhe përgjegjësinë shoqërore të aktivitetëve të Kolegjit dhe të inkurajoj autonominë e mësimdhënies dhe mësimnxënjes dhe lirinë e hulumtimit shkencor me qëllim që të promovojë imazh pozitiv të Kolegjit.

I. PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Anëtarët e komunitetit të Kolegji, stafi akademik, studentët dhe administrata për shërbime studentore tëshprehin besnikërinë e tyre ndaj Kolegjit Dardania duke respektuar parimin bazë të zbatimit dhe të ruajtjes së vlerave themelore tëtij.

Neni 2

Vlerat themelore të Kolegjit Dardania janë: përsosmëria, ndershmëria, autonomia, liria në mësimdhënie dhe në hulumtime shkencore, me të cilat arrihet respektimi i integritetit personal,

humanizimi i raporteve ndërnjerzore, drejtësia, barazia dhe e vërtetasi vlerë më e lartë. Për të zbatuar këto vlera stafi akademik, studentët dhe administrata për sherbime studentore përpiqen për integritet dhe përgjegjshmëri ndaj punë së tyre, e kjo arrihet përmes qëndrimit kritik, tolerancës dhe sinqeritetit.

Neni 3

Anëtarët e komunitetit tëKolegjit e mbështesin misionin e Kolegjit duke kryer në mënyrë të plotë dhe permanente aktivitetet e tyre, nga ana e mësimdhënësve, hulumtuesve, studentëve, stafi administrativ, duke marrë pjesë në mënyrë të përgjegjëshme në organet përkatëse dhe duke vepruar në përputhje me vlerat themelore të Kolegjit dhe jashtë mjedisit tëtij.

Neni 4

Integriteti i mësimdhënësit, hulumtuesit dhe studentëve të Kolegjit shprehet kryesisht nëpërmjet sjelljes etike.

Neni 5

Një qëndrim i përgjegjshëm ndaj punës nga ana e tërë komunitetit të Kolegjit demostrohet me përmbushjen e plotë dhe të rregullt të detyrimeve të punës dhe me iniciativë e gadishmëri për tu angazhuar edhe në detyrat e tjera sipas nevojes. Anëtaret e stafit akademik të Kolegjit dhe hulumtuesit ushtrojnë qëndrim të përgjegjshëm të punës përmes angazhimit në mësimdhënie dhe në hulumtime shkencore, dhe rezultatet e arritura kontribuojnë në drejtpërdrejt nëzhvillimin profesional dhe në avansimin në karrierë.

Neni 6

Qëllimi themelor i tërë komunitetit të Kolegjit: stafit akademik, hulumtuesve dhe studentëve është pavarësia intelektuale, e cila mundëson qëndrim kritik konstruktiv në refuzimin ndaj çdo apriorizmi në veprimtarinë profesionale dhe në hulumtime shkencore.

Neni 7

Kolegji Dardania promovon standarde të larta akademike dhe profesionale. Nga studentët pritet që gjithnjë të kenë qëndrim të drejtë ndaj punës dhe aktiviteteve mësimore, të sillen në mënyrë

etike, veçanërisht gjatë orëve të mësimit, kur paraqesin punën e tyre për vlerësim dhe gjatë provimeve. Studentët duhet të respektojnë të gjitha normat që parashihen me Kodin e Etikës, në të cilin specifikohen të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit akademik, stafit administrativ dhe të studentëve. Veçmas duhet patur kujdes dhe sjellje akademike ndaj veprimeve si: plagjiatura, mashtrimi në provime, prirja për të përfaqësuar një person tjetër në provime, falsifikimi ose trillimi i të dhënave në një punim seminarik, komunikimi i paautorizuar gjatë provimeve, angazhimi I një personi tjetër për të përfaqësuar punën e dikujt tjetër si dhe paraqitja e të njëjtës detyrë në më shumë se një lëndë, apo keqpërdorimi ose dëmtimi i qëllimshëm i pajisjeve teknologjike dhe pajisjeve të tjera brenda ambienteve të kolegjit.Veprimet e mësipërme jo vetëm që nuk i përkasin subjekteve akademike por njëkohësisht ato janë joetike.

Neni 8

Hapja ndaj ideve të reja është themeli i krijimtarisë shkencore dhe një nga virtytet kyçe të mësimdheniës dhe mësimnxënjes. Kritika konstruktive konsiston në pranimine përgjegjshëm të ideve të reja, të cilat sigurojnë nivel të lartë të cilësisë që parandalojnë thjeshtëzimin dhe ekstremizmin.

Neni 9

Toleranca nga ana e komunitetit të Kolegjit mundëson pranimin e diversitetit. Avokimi i vlerave në mënyrë të përgjegjshme parandalon tolerancen nga kthimi në indifirencë dhe në apati.

Neni 10

Besnikëria e komunitetit të Kolegjit shprehet në angazhimin e përgjithshëm për ruajtjen e vlerave të arritura në mësimdhënie, kërkim shkencor si dhe në përfaqësimin publik të Kolegjit.

II. MËSIMDHËNIA

Neni 11

Liria akademike është e drejta dhe përgjegjësia themelore e anëtarëve të komunitetit të Kolegjit, të stafit akademik dhe të studentëve. Anëtarët e stafit akademik ushtrojnë lirinë e tyre akademike

përmes mësimdhënies bashkëkohore, gjetjeve empirike si deshmi e kerkimit shkencor, dhe aktiviteteve kreative të cilat janë në përputhje me standardet etike të pranuara përgjithësisht.

Neni 12

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit përbëjnë një tërësi të pandashme që paraqesin gadishmëri dhe perkushtim për të siguruar studentëve mjedis inkurajues në të nxënit, ndërsa studentët kontribojnë në rrjedhën normale të procesit mësimor përmes punës së tyre të ndërgjegjëshme dhe të përgjegjëshme që ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.

Neni 13

Qëllimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana e stafit akademik është përhapja e njohurive dhe nxitja e mendimit kreativ, kritik dhe të përgjegjshëm.

Neni 14

Me lirinë akademike të studentëve nënkuptohet autonomia në arritjen e qëllimeve të tyre, përmes studimit të përgjegjshëm dhe iniciativës personale si dhe miratimit të sjelljes etike në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuara me Kodin Etik të Kolegjit Dardania.

III. HULUMTIMET

Neni 15

Aktivitetet kërkimore shkencore bazohen në lirinë e hulumtimit, ndershmeri në kerkime dhe ne integritet personal në hulumtime.

Neni 16

Ndershmeria në hulumtimin shkencor përfshin respektimin e vazhdueshëm të autorësisë, të njohjes së sakt të arritjeve kërkimore shkencore të studiuesve të tjerë, me citim. Përdorimi i vazhdueshëm i metodave të përshtatshme të hulumtimit sjellin një shqyrtim objektiv të hipotezave kërkimore, që rezulton me interpretim profesional të drejtë të rezultatevenë të dhëna.

Neni 17

Përveq rregulloreve në fuqi hulumtuesit e Kolegjit Dardania i përmbahen rregullave dhe standardeve etike, të pranuara ndërkombëtarisht të cilat zbatohen në fusha specifike të hulumtimit shkencor.

IV. AKTIVITETET DHE SJELLJA E ANËTARËVE TË FAKULTETIT, PERSONELIT TË UNIVERSITETIT DHE STUDENTËVE JASHTË MJEDISIT TË UNIVERSITETIT

Neni 18

Anëtarët e komuntetit të cilët veprojnë jashtë Kolegjit si persona privat duhet t'i respektojnë vlerat dhe standardet etike siç përcaktohen me Kodin Etik të Kolegjit.

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit kanë të drejtë të bashkohen me shoqatat profesionale, partit politike, bashkësi fetare dhe organizata të tjera si persona privat. Këta persona privat në aktivitetet e tyre duhet t'i shmangen konfliktit të interesit duke mos bie ndeshë me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në Kolegj.

Neni 19

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit: stafi akademik, studentët, administrata të cilët janë të emëruar si përfaqësues të një partie politike nuk mund të zgjidhen apo të emërohen në ndonjë pozitë drejtuese brenda Kolegjit.

Aktivizimi politik ose ndonjë formë tjetër e propagandës në mjediset e Kolegjit nëse perdoret si mjet i shfrytëzimit në proces të mësimdhënies paraqesin shkelje serioze të Kodit Etik.

V. VEPRIMTARIA JASHTË KOLEGJIT

Neni 20

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit nuk mund të kryejnë aktivitete jashtë saj nëse pengojnë në rrjedhen normale të procesit të mësimdhënies, hulumtimeve ose në punët administrative.

Neni 21

Anëtarët e komunitetit të Kolegjit kur përfshihen në aktivitete të tjera jashtëtij duhet ti përmbahen vlerave themelore dhe rregullave të Kodit Etik të Kolegjit, veçanërisht në lidhje me ndërshmerinë, qëndrimin kritik dhe dinjitetin profesional akademik.

VI. SJELLJA NDAJ BURIMEVE TË KOLEGJIT

Neni 22

Të gjithë anëtarët e komunitetit: stafi akdemik, studentët, personali administrative në perdorimin eobjektit, pajisjeve dhe mjeteve financiare të cilat u janë besuar për qëllime të caktuara duhet të tregohen të kujdesshëm, ti përdorin ato ekonomikisht sepse janë dobi të përfitimit për komunitetin e tëmos përdoren për përfitime private.

VII. POZITAT ADMINISTRATIVE NËKOLEGJ

Neni 23

Anëtarët administrativ të Kolegjit dhe studentët, të cilët mbajnë poste administrative duhet ti përmbahen standardeve të Kodit Etik të Kolegjit, duke i kryer detyrat në frymën e traditës akademike, me përkushtim dhe përgjegjësi. Këta anëtarë duhet marrë parasysh efektet afatgjata të masave që ata propozojnë dhe prezentojnëduhet arritur konsensus në vendimarrje për t'ju shmangur tejkalimit tëmbivotimit të njëri tjetrit.

VIII. KOMITETI I KODIT ETIK

Neni 24

Këshili Drejtues i Kolegjit Dardania me propozim të Senatit të Kolegjit emëron Komitetin e Kodit Etik dhe përcakton anëtarësinë, afatin e shërbimit dhe përgjegjësitë e tij.

IX. MASAT DISIPLINORE

Neni 25

Stafi akademik, studentët dhe personeli administrativ të cilët kanë shkelur një ose më shumë nga standardet e sjelljes të Kodit Etik duhet t'iu nënshtrohen masave disiplinore që vijojnë më poshtë:

1. Paralajmërim
2. Afat prove
3. Dëmshpërblim
4. Përjashtim

Neni 26

Shqiptimin e masave disiplinore nënjësitë akademike të Kolegjit e bënë Komisioni disiplinor. Rishqyrtimi i tyre poashtu bëhet në njësitë akademike nga Komisioni i ankesave të emëruar nga Këshillat shkencore –mësimore të njësive akademike të Kolegjit, të cilët veprojnë në pajtim me rregulloren për përgjegjësinë disiplinore të tërë komunitetit të Kolegjit Dardania.

Neni 27

Komiteti i Kodit Etik i emëruar nga Këshilli Drejtues i Kolegjit, i rishqyrton ankesat e palëve në vendimin e Komisionit displinor dhe të Komisionit të ankesave, si dhe ankesat tjera të palëve të dëmtuara në pajtim me rregulloren për përgjegjësinë displinore të dedikuar për komunitetin e Kolegjit Dardania

Neni 28

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtuës të Kolegjit Dardania.

KRYESUESI I KËSHILLIT DREJTUES

Prof. Dr. Haki Demolli